

**KRYETARI I KOMUNËS**  
**MUNICIPAL PRESIDENT**  
**PRESDENIK OPSTINE**

Tel / Fax: 038/200-46002  
 Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.  
 E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)

DATA/DATUM/DATE	18.09.2024
NR/BR.	301/24
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objekteve të Institucioneve Parashkollor-Çerdheve

Në mbështetje të nenit 58, shkronja (h) e Ligjit nr. 03/ L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtaree Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), nenit 6 pika 1, neni 8 pika 1, të nenit 14 pika 1, të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 10/03 Prill 2019), të nenit 5 pika 1.2, 6 pika 3, të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të nenit 51 Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013, në cilësi të Kryetarit të Komunës së Ferizajt, pas rekomandimit të Kuvendit Komunal me nr.01 Nr. 17 të datës 29.02.2024 i propozon Kuvendit të Komunës:

#### Vendimin

#### Paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së Komunës

1. Miratohet Vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - objekteve të Institucioneve Parashkollor-Çerdheve, personave fizik/juridik.
2. Pronat e paluajtshme të propozuar për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër janë;
  - a. Institucioni Parashkollor-Çerdhja "Engjujt" në Lagjën e Re, Ferizaj, i ndërtuar në parcelën kadastrale P-72217092-00343-1 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt.
  - b. Institucioni Parashkollor-Çerdhja në Rrugën "Rexhep Bislimi", Ferizaj, i ndërtuar në parcelën kadastrale P-72217092-03280-0 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt.
  - c. Institucioni Parashkollor-Çerdhja në fshatin Greme, i ndërtuar në parcelën kadastrale P-72217024-02155-1 dhe P-72217024-02154-1 Z.K. Greme, pronë e Komunës së Ferizat.

- d. Institucioni Parashkollor-Çerdhja në fshatin Babush i Ri, i ndërtuar në parcelën kadastrale P-72209079-00656-0 Z.K. Babush i Ri, pronë e Komunës së Ferizajt,**
- e. Institucioni Parashkollor-Çerdhja në fshatin Lloshkobare, i ndërtuar në parcelën kadastrale P-72217056-00833-2 Z.K. Lloshkobare, pronë e Komunës së Ferizajt.**
3. Çmimi për institucion është 100 euro, çmimi është mujor, çmimi është fiks sepse interesi i komunës është funksionalizimi i institucioneve parashkollore e jo përfitimi financiar.
  4. Komuna e Ferizajt merr përsiper heqjen e shpenzimeve (ujë, tatim dhe mbeturina) për këto institucione parashkollore – Çerdhe.
  5. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është rritja e përfshirjes sa më të madhe të fëmijëve në kopshte duke u bazuar edhe në Ligjin për Edukimin e Hershëm nr. 08/L-153, neni 12 dhe 13, si dhe zvogëlimi i shpenzimeve të Komunës për blerjen e shërbimeve për këtë qëllim.
  6. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën II të këtij ropozimi është afatshkurtër, në periudhën deri 15 vjet.
  7. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër bëhet përmes konkurrencës (ankandit) të hapur publik, aplikuesit - ofertuesit duhet të përshkruajn pikën e njësisë për të cilën aplikojnë.
  8. Fitues shpallet ofertuesi që ofron garancion se do të iu vazhdohet kontrata e punës të gjithë të punësuarve të cilët janë në marrëdhënie pune me Caritas Kosova deri në përfundim të marrëveshjes për marrje në shfrytëzim të pronës së Komunës, sistemimi dhe shpërndarja e numrit të punëtorëve do të bëhet me marrëveshje në mes DKA-së dhe Përfituesve.
  9. Afati i funksionalizimit të Institucioneve Parashkollore – Çerdheve, do të bëhet maksimumi 60 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
  10. Fituesi i ankandit shpallet ofertuesi që ofron çmimin më të ulët për sistemimin e fëmijëve në kopsht.

***Kriteret për vlerësim të ofertës.***

1. Depozita e ofertes 10,000.00€.
2. Vlera minimale e investimeve 100,000.00 euro për objektet – Institucionin Parashkollor që duhet rregullohen/renovohen/adaptohen.
3. Garancioni bankar per investime në vlerë të investimit.
4. Deklarata e besueshmerise financiare në vlerë 600,000.00 €.

***Detyrate përfituesit:***

1. Bashkepunimi me DKA për zhvillimin e te gjitha procedurave duke u bazuar në rregullativen ligjore të Arsimit Parauniversitar.
2. Bashkepunimi DKA për stafin menaxherial dhe edukativ në planifikimin, ngritjen dhe zhvillimin e Institucionet Parashkollor.
3. Bashkepunimi me DKA për monitorimin dhe mentorimin e procesit edukativ ne Institucionet Parashkollore.

4. Bashkepunimi me DKA ne ngritjen e kapaciteteve te stafit menaxherial, edukativ dhe teknik te institucionit.

#### ARSYETIM

Duke pasur parasysh se në Komunën tonë janë funksionale dy çerdhe njëra publike dhe tjetra në partneritet me Caritas KOSOVA është parë nevoja që të funksionalizohen edhe çerdhe të tjera, meqenëse funksionalizimi i objekteve të cilat janë të ndërtuara dhe ato në ndërtim e sipër nuk po arrijnë të funksionalizohen përshkak të mungesës së rritjes së stafit menaxherial, edukativ, profesional e teknik, DKA duke u bazuar në Ligjin për Edukimin e Hershëm nr. 08/L-153, neni 12 dhe 13 si dhe në kërkesat e vazhdueshme të prindërve për sistemimin e fëmijëve të tyre në institucione parashkollore ka paraqitur para anëtarëve të Kuvendit që të miratohet ky vendim për dhënien në shfrytëzim të objekteve të lartcekura.

Funksionalizimi i këtyre Institucioneve:

- Do të krijoj mundësi në zhvillimin e hershëm të fëmijëve të cilët do të përfitojnë në zhvillimin e aftësive të tyre, kognitive, fizike, emocionale,
- Do të ndikoj në socializimin sa më të hershëm të fëmijëve të cilët do të jenë më të përgatitur për fazat e tjera të shkollimit,
- Do të ndikoj në rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm, ngase aktualisht ne sistemin edukativ kemi afërsisht 30% të fëmijëve të përfshirë në zhvillimin e edukimit të hershëm.
- Do të jetë një mbështetje e madhe edhe për prindërit të cilët janë në marrëdhënie pune dhe të atyre të cilëve do të iu mundësohet më lehtë të lidhin marrëdhënie të re pune si dhe mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në ndjekjen e kurseve, trajnimeve, seminareve etj që ndikojnë në ngritjen e tyre profesionale,
- Do të krijoj siguri dhe besueshmëri të prindërit për një vend më të sigurt.
- Do të lehtësohej buxhetin komunal.

Nga ajo që u tha më lartë propozojmë Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që të aprovoj propozim- vendimin ashtu siç është përshkruar më lartë.

*Të bashkangjitur në këtë propozim gjeni;*

- *Certifikatat e pronësisë,*
- *Vendimin për publikimin e listës së pronave.*